



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 6615 | Prot.

Tiranë, më 19.09.2023

4

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1163/1, datë 19.07.2012.

SHOQËRISË “KLERVIBRIS” SH.P.K

Lagja e Re, Godinë 2 katëshe pranë Shkolles 9 Vjeçare, Kati 1, Bulqizë, Dibër.

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “KLERVIBRIS” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1163/1, datë 19.07.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Galeria 65&66”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3952/1, datë 07.09.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 6615/3, Prot., datë 11.09.2023, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1163/1, datë 19.07.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Galeria 65&66”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi subjekti nuk ka drejtues teknik në objekt dhe në objekt nuk zhvillohet aktivitet minrar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “g” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1163/1, datë 19.07.2012, për mineralin krom, në Objektivin “Galeria 65&66”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesni sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1163/1, datë 19.07.2012, për mineralin krom, në Objektivin "Galeria 65&66", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

